



VENDIM

Nr.60 Datë 19.08.2009

**PËR
PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUES (PARKU EOLIK
MASKURI) TË SHOQËRISË “RUNNING ENERGY” SI BURIME TË
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007 “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme”, neni 9, pika 1 dhe pika 2, germa a, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.08.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime te rinovueshëm energjie

Konstatoi se:

- Me vendimin Nr.48, date 06.07.2009, Bordi i Komisionereve ka filluar procedurat e shqyrtimit te aplikimit te shoqerise “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime te rinovueshëm energjie
- Dokumentacioni bashkelidhur aplikimit eshte ne perputhje me kerkesat e neneve 6 dhe 7, pika 1, 2 dhe 3 te Rregullores se Procedurave te Çertifikimit te Prodhimit te Energjise Elektrike nga Burimet e Rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI :

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik Maskuri) të shoqërisë “RUNNING ENERGY ” si burime të rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.60 Datë 19.08.2009

**PËR
PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUES (PARKU EOLIK
MASKURI) TË SHOQËRISË “RUNNING ENERGY” SI BURIME TË
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Anetaret e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____